

Balfin sh.p.k

**Pasqyrat financiare për vitin e
mbyllur më 31 dhjetor 2014**

PERMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

1.	INFORMACIONE TE PERGJITHESHME.....	5
2.	BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE.....	5
3.	GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME	5
3.	GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM).....	6
4.	POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL	6
5.	MJETE MONETARE	12
6.	KERKESA TE ARKETUESHME	12
7.	KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME	12
8.	INVENTARI I IMET	13
9.	PARAPAGESA PER FURNIZIME.....	13
10.	AKSIONE DHE PJESEMARRJE TE TJERA NE NJESITE E KONTROLLUARA	14
11.	AKSIONE DHE INVESTIME TE TJERA NE PJESEMARRJE.....	14
12.	KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA	15
13.	AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE	15
14.	HUATE DHE OBLIGACIONET AFATSHKURTRA.....	16
15.	TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE.....	16
16.	DETYRIMET TATIMORE	16
17.	DIVIDEND PER TU PAGUAR	16
18.	TE ARDHURA TE SHTYRA	16
19.	HUA AFATGJATA	17
20.	HUAMARRJE TE TJERA AFATGJATA.....	17
21.	KAPITALI AKSIONAR	17
22.	SHITJET NETO	17
23.	TE ARDHURAT TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	18
24.	SHPENZIME NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT.....	18
25.	TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE	18
26.	SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN	19
27.	PALET E LIDHURA	19
28.	NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT	19

PËR AKSIONERËT E BALFIN SH.P.K

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Balfin sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më 31 dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të parasë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësitë e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe kontrollin e brendshëm në masën e përcaktuar nga drejtimi, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve dhe gabimeve.

Përgjegjësitë e audituesit të pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të pasqyrave financiare të Shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontable të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë të auditimit.

Opinionini

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit sic përshkruhen në shënimin 2 Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Cështje të tjera

Tërheqim vëmendjen në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, që tregon Bazat e përgatitjes të pasqyrave financiare dhe faktin që këto pasqyra financiare janë përgatitur për qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore për auditimin e pasqyrave financiare vjetore.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë audituar nga auditues të tjerë të cilët kanë lëshuar një opinion të pamodifikuar më 18 mars 2014.

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k,
Shkup-Dega Tiranë

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k

Mario Vangjel

13 maj 2015
Tiranë, Shqipëri

BALFIN SH.P.K
PASQYRA FINANCIARE VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E SITUATES FINANCIARE

AKTIVET	Shenime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 riparaqitur
Aktivitet Afatshkurtra			
Mjete monetare	5	28,702,298	94,821,443
Totali		28,702,298	94,821,443
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari / Kërkesa te arkëtueshme	6	71,265,674	23,368,794
Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	7	232,882,966	40,418,927
Totali		304,148,640	63,787,721
Inventari			
Lëndët e para/Inventar i imet	8	8,755	82,778
Parapagesa për furnizime dhe shpenzimet e shtyra	9	4,747,729	522,412
Totali		4,756,484	605,190
AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA		337,607,421	159,214,354
Aktivitet Afatgjata			
Investimet financiare afatgjata			
Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi te kontrolluara (vetëm për pasqyrat financiare të pakonsoliduara)	10	2,376,607,357	2,389,086,546
Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje	11	746,513,106	681,835,644
Llogari / Kërkesa te arkëtueshme afatgjata	12	2,467,255,005	2,632,397,606
Totali		5,590,375,468	5,694,319,797
Aktive afatgjata material			
Makineri dhe paisje (minus amortizmi)	13	5,924,558	5,600,222
Aktive të tjera afatgjata materiale (me vlere kontabel te mbetur)	13	19,488,939	19,754,079
Totali		25,413,497	25,354,301
Aktive biologjike afatgjata			
Aktivitet afatgjata jomateriale			
Aktive të tjera afatgjata jomateriale	13	1,014,701	-
Totali		1,014,701	-
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		5,616,803,666	5,719,674,098
TOTALI AKTIVEVE		5,945,411,087	5,878,888,452
PASIVET DHE KAPITALI			
Huamarrjet			
Huat dhe obligacionet afatshkurtra	14	111,700,504	52,483,422
Totali		111,700,504	52,483,422
Huat dhe parapagimet			
Te pagueshme ndaj furnitorëve	15	25,833,449	28,567,367
Detyrimet tatimore	16	2,023,260	5,006,586
Dividend per tu paguar	17	120,879,411	120,879,411
Totali		148,736,120	154,453,364
Grandet dhe të ardhurat e shtyra	18	70,070,000	70,100,000
Provizionet afatshkurtra			
TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA		330,506,625	277,036,786
Huat afatgjata			
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	19	-	128,526,586
Totali		-	128,526,586
Huamarrje të tjera afatgjata	20	2,015,486,342	1,956,412,503
TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA		2,015,486,342	2,084,939,089
TOTALI I PASIVEVE		2,345,992,966	2,361,975,875
Kapitali	21	3,608,418,121	3,570,198,391
Kapitali aksionar		3,216,205,000	3,216,205,000
Rezerva statusore		199,859	199,859
Fitimet e pashpërndara		300,507,544	-
Fitimi (humbja) e vitit financiar		91,505,544	300,507,718
TOTALI I KAPITALIT		3,608,418,120	3,516,912,577
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		5,954,411,087	5,878,888,452

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

BALFIN SH.P.K
PASQYRA FINANCIARE VITI 2014

(Vlerat ne ALL)


PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

	Shenime	Vitii mbyllur më 31 dhjetor 2014	Vitii mbyllur më 31 dhjetor 2013 riparaqitur
Shitjet neto	22	57,495,844	52,630,638
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë shfrytëzimit	23	99,708,046	115,189,689
Ndryshimet në inventarin e p.gatshme dhe p. proces		-	-
Puna e kryer nga njësia ekonomike raportuese për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar		-	-
Mallra, lëndët e para dhe shërbimet		-	-
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	24	(50,294,367)	(63,993,452)
Shpenzime të personelit		(62,596,983)	(73,839,266)
Pagat		(56,222,303)	(68,041,096)
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore		(6,099,701)	(5,496,506)
Shpenzimet te tjera		(274,979)	(301,664)
Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi		(7,196,314)	(6,020,764)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		38,481,079	23,966,846
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësite e kontrolluara		-	303,930,415
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	25	54,389,318	(15,304,922)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		56,101,766	(17,658,387)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit		(1,712,448)	2,353,465
Të ardhurat dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
Fitimi (humbja) para tatimit		91,505,545	312,592,338
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15 % (10%)	26	-	12,084,621
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		91,505,545	300,507,718

Pasqyra e te ardhurave gjithëpërshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Edlira Muka
Administratori


BALFIN
 Balkan Finance Investment Group


Blerina Daka
Drejtores e financës

BALFIN SH.P.K
PASQYRA FINANCIARE VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE¹

Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
		riparaqitur
Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	26	91,505,545
Rregullimet për :		365,878,152
Amortizimin	13	7,196,314
Humbjet (fitimet) nga këmbimet valutore	25	6,020,764
Të ardhura nga investimet	23	(2,353,465)
		(484,664,586)
Të ardhura nga interesat	25	(59,134,088)
Shpenzime për interesa	25	(928,813)
Rritje / rënie në tepëricën e kërkesave të arketueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arketueshme të tjera		113,742,879
Rritje / rënie në tepëricën inventarit		(477,352,403)
Rritje / rënie në tepëricën detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		10,079
Interesi i paguar		394,753,350
Tatim fitimi i paguar	26	60,980
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		
Fluksi i parave nga veprimtaritë e investuese		
Blerja e shoqërisë së kontrolluar minus paratë e arkëtuara		53,499,839
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	13	(789,490,770)
Të ardhura nga shitja e paisjeve		-
Dividendët e arkëtuara		-
Hua të dhëna	19	-
Paraja neto, e perdorur në aktivitetet e investuese		
Fluksi i parave nga veprimtaritë e financiare		
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		8,642,973
Huamarrje afatgjata		(282,035,907)
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		(388,338,536)
Dividendë të paguar		-
Para neto e perdorur në aktivitetet financiare		
Rritja / renia neto e mjeteve monetare		
Humbjet (Fitimet) nga këmbimet valutore	25	67,511,422
Mjete monetare në fillim të periudhës kontabel	5	709,311,248
Mjete monetare në fund të periudhës kontabel	5	(50,334)
		-
		-
		62,564,731
		(59,941,267)
		771,825,645
		281,192,597
		(60,784,577)
		(1,712,448)
		94,821,443
		32,324,417
		94,821,443

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

¹ Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare është përgatitur sipas metodës indirekte.

BALFIN SH.P.K
PASQYRAT FINANCIARE VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali i kapitaleve të veta
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	3,216,205,000	-	-	199,859	134,310,457	3,350,715,316
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	300,507,718	353,793,532
Dividendët e paguar	-	-	-	-	(134,310,457)	(134,310,457)
Rritje e rezervës kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2013 (riparaqitur)	3,216,205,000	-	-	199,859	300,507,718	3,516,912,577
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	91,505,545	91,505,545
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	3,216,205,000	-	-	199,859	392,013,262	3,608,418,121

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Balfin sh.p.k. është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë 25 Tetor 2007 dhe është regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit në regjistrin e shoqërive tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 100,000 leke. Me datë 08.04.2008 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria ndryshon emrin e saj nga Samir Mane Consulting Group në Balfin sh.p.k. Me datë 24.10.2008 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë me 12,300,000 leke, në datën 05.07.2009 në Qendren Kombëtare të regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë me 2,330,580,000 leke. Në datën 19.03.2012 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë në natyrë për vlerën 873,225,000 leke Kapitali i shoqërisë në 31.12.2014 është **3,216,205,000 leke**. Administrator dhe aksioner i vetëm është Z. Samir Mane i cili zoteron **100%** të aksioneve të shoqërisë me vlerë nominale për një aksion **32,162,050 leke**.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti: Aktiviteti i shoqërisë është investimi dhe konsulenca.

Certifikimi tatimor: NIPT K72223031K

Forma juridike e shoqërisë: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Adresa e selisë: ABA Busines Center, Kati 11, Tirane

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë të mara me qira.

Numri i punonjësve me datë 31 dhjetor 2014 ka qenë 39 punonjës.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

Kompania ka përgatitur keto pasqyra financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK") për pasqyrat financiare të vecanta me qëllim plotësimin e kërkesave për raportim të pasqyrave financiare ligjore.

Meqenëse SKK kërkon përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të vecanta mund të mos jenë të mjaftueshme për tu përdorur si pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për të plotësuar kërkesat e gjithë përdoruesve pasqyrave financiare. Pasqyrat e konsoliduara të Shoqërisë do të leshohen pas datës së aprovimit të ketyre pasqyrave.

Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2014 në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lekë shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpyetje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

3. GJYKIMET, VLERSIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

3. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit mbi fitimin të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njihet detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumën e cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ose ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Rregullimet e gabimeve

Gjatë vitit nën auditim Shoqëria identifikoi një gabim në zërat e pasqyrave financiare të vitit të kaluar që mbyllej më 31 Dhjetor 2013. Sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit këto gabime janë rregulluar duke riparuar balancën hapëse të Kapitalit Aksionar dhe zërave të krahasueshëm si më poshtë:

PASQYRA E SITUATES FINANCIARE

AKTIVET	31 dhjetor 2014 para riparaqitjes	Rregullimi i gabimit	31 dhjetor 2014 riparaqitur	31 dhjetor 2013 para riparaqitjes	Rregullimi i gabimit	31 dhjetor 2013 riparaqitur
Aktivitet Afatshkurtra						
Mjete monetare	28,702,298		28,702,298	94,821,443		94,821,443
AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA	337,607,421		337,607,421	159,214,354		159,214,354
Aktivitet Afatgjata						
Investimet financiare afatgjata						
Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm për pasqyrat financiare të pakonsoliduara)	2,376,607,357		2,376,607,357	2,389,086,546		2,389,086,546
Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje	746,513,106		746,513,106	681,835,644		681,835,644
Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata	2,520,540,819	53,285,814	2,467,255,005	2,676,683,420	53,285,814	2,632,397,606
Totali	5,643,661,282		5,590,375,468	5,747,605,611		5,694,319,797
Aktive afatgjata materiale	25,413,497		25,413,497	25,354,301		25,354,301
Aktive afatgjata jo materiale	1,014,701		1,014,701	-		-
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	5,670,089,479		5,616,803,666	5,772,959,912		5,719,674,098
TOTALI AKTIVEVE	6,007,696,901		5,945,411,087	5,932,174,266		5,878,888,452
PASIVET DHE KAPITALI						
Huamarrjet	111,700,504		111,700,504	52,483,422		52,483,422
Huat dhe parapagimet	148,736,120		148,736,120	154,453,364		154,453,364
Grandet dhe të ardhurat e shtyra	70,070,000		70,070,000	70,100,000		70,100,000
TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA	330,506,625		330,506,625	277,036,786		277,036,786
TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA	2,015,486,342		2,015,486,342	2,084,939,089		2,084,939,089
TOTALI I PASIVEVE	2,345,992,966		2,345,992,966	2,361,975,875		2,361,975,875
Kapitali	3,608,418,121		3,608,418,121	3,570,198,391		3,570,198,391
Kapitali aksionar	3,216,205,000		3,216,205,000	3,216,205,000		3,216,205,000
Rezerva statusore	199,859		199,859	199,859		199,859
Fitimet e pashpërndara	353,793,532	53,285,814	300,507,544	-		-
Fitimi (humbja) e vitit financiar	91,505,544		91,505,544	353,793,532	53,285,814	300,507,718
TOTALI I KAPITALIT	3,661,703,934		3,608,418,120	3,570,198,391		3,516,912,577
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	6,007,696,901		5,954,411,087	5,932,174,266		5,878,888,452

BALFIN
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

(b) Rregullimet e gabimeve (vazhdim)

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

	Vitii mbyllur më 31 dhjetor 2013 para riparqitjes	Rregullimi i gabimit	Vitii mbyllur më 31 dhjetor 2013 riparqitur
Shitjet neto	52,630,638		52,630,638
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë shfrytëzimit	168,475,503	53,285,814	115,189,689
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(63,993,452)		(63,993,452)
Shpenzime të personelit	(73,839,266)		(73,839,266)
Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi	(6,020,764)		(6,020,764)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit	77,252,660		23,966,846
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	(15,304,922)		(15,304,922)
Fitimi (humbja) para tatimit	365,878,152		312,592,338
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15 % (10%)	12,084,621		12,084,621
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	353,793,532		300,507,718

Gjatë vitit 2013 është kontabilizuar dy herë të ardhurat nga dividendi, dhe për këtë arsye të ardhurat nga dividendi janë rregulluar për vlerën e Lek 53,285,814.

(c) Transaksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2014, 1 Euro me 140.14 Lekë dhe 1 USD me 115.23 Lekë.

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

(b) Instrumentat financiar

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose me pak. Për qellime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhënieve bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

Te tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet. *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rrezikët dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet afatgjata investimi maten me modelin e koston. Aktivet afatgjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrën shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për tu dhënë me qera.

(d) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitetit afatgjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast të është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitet ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

a) Makineri e Pajisje	20%
b) Mjete transporti	20%
c) Pajisje informatike	25%
d) Inventari i imet	50%

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivitet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(d) Aktive afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

Zhvlerësimi

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivitet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e

(d) Aktive afatgjata material (vazhdim)

aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasas dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitet ose e njësisë të tij të gjenerimit të pasas tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse.

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

(e) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecures normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenziemeve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqëria njihet si detyrim shumë e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(f) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(g) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecures normale të aktiviteteve të biznesit.

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë. Të ardhurat përfshijnë shumën neto pa përfshirë shumën e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronesisë së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

(h) Të ardhurat nga qeratë

Të ardhurat nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përveç të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negociimit të një kontrate qeraje njihen si shpenzime në terma të qerasë me të njëjtat baza si të ardhurat nga qeraja.

Përpjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë afatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anulueshme qeraje së bashku me afatet e tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumën e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për të marrë ato..

(i) Pagesat për qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten me kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

(j) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(k) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston së aktivitetit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(l) Taksat

Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2014

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

(m) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

5. MJETE MONETARE

Ne kete ze perfshihen mjetet monetare gjendje ne date 31.12.2014, ne llogarite njedhese prane bankave te nivelit te dyte si dhe ne arke.

Mjete Monetare	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
I. Para ne dore	92,142	69,083
Ne monedhe vendase	21,797	47,757
Ne monedhe te huaj	70,345	21,326
II. Llogari ne banke	28,610,156	20,907,415
Ne monedhe vendase	17,022,110	1,693,482
Ne monedhe te huaj	11,588,046	19,213,934
Total mjete monetare (I+II)	28,702,298	94,821,443

Vlera e mesiperme perfaqeson vleren e likujditeteve ne date 31.12.2014 dhe 2013, gjendje ne llogarite dhe dopozitat qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ne leke dhe valute, dhe gjendjen e arkës ne leke.

6. KERKESA TE ARKETUESHME

Ne kete ze jane perfshire “kerkesa te arketueshme” nga klientet dhe shoqeri te Grupit, “Kostoja e amortizuar” eshte metoda e perdorur per vleresimin e tyre.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Sherbime konsulence drejt shoqerive te Grupit	68,726,292	20,846,551
Sherbime konsulence drejt klienteve te tjere	2,539,382	2,522,243
Totali	71,265,674	23,368,794

Ne postin Kliente per shitje e sherbime konsulence, jane paraqitur vlerat per tu arketuar nga te tretet dhe shoqeri te Grupit Balfin, per shitjen e sherbimeve.

7. KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME

Ne kete ze jane perfshire te drejtat tatimore per kestet mujore per tatim fitimin te parapaguar, tatimi per dividendin e parapaguar nga shoqeria Neptun Maqedoni ne Maqedoni e cila pritet te njihet si tatim i kreditueshem nga Drejtoria tatimore gjate vitit 2015 dhe hua Afat shkurtra te dhena shoqerive ne te cilat Balfin zoteron aksione. Keto hua do te likujdohen brenda vitit 2015.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Hua Afatshkurter Albchrome	216,946,134	34,440,490
Hua Afatshkurter TBU	4,904,900	-
Tatime te shtyra	5,564,392	5,566,390
Tatim Fitim i parapaguar	2,965,867	-
Hua Afatshkurter CMB	2,345,468	-
Paradhenie per punonjesit	156,206	-
TVSH ne blerje	-	412,047
Totali	232,882,966	40,418,927

Huaja afatshkurter e dhene Shoqerise “Tirana Business University” (TBU) sipas kontrates do te disbursohet per nje periudhe tre vjecare, pas kesaj periudhe do te konvertohet ne kuota kapitali.

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

8. INVENTARI I IMET

Ne kete ze jane perfshire gjendjet e "Inventarit te imet", te cilat perdoren per nevoja te shoqerise. Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ateherë kur ka faktore objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar. Metoda e perdorur nga shoqeria per vleresimin e stokut, eshte metoda e koston mesatare te ponderuar.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Inventari i imet	589,588	562,774
Shtesa gjate vitit	-	22,281
Amortizimi	(580,833)	(502,277)
Totali	8,755	82,278

Ne kete grup jane paraqitur rezervat materiale per nevoja te shoqerise. Vleresimi i gjendjeve eshte bere me koston mesatare te blerjes. Kjo llogari eshte njohur me nje norme zhvleresimi 50 % ne fund te vitit financiar.

9. PARAPAGESA PER FURNIZIME

Ne kete ze jane perfshire gjendjet e parapagimet e dhena per qirane e nje makine te marre nga shoqeria per nevojat e aktivitetit te saj.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Parapagime	84,102	-
Depozita per qera	3,622,119	-
Shpenzime te shtyra	1,041,508	522,412
Totali	4,747,729	522,412

Ky parapagim eshte nje forme garancie nga qiradhenesi deri ne momentin e perfundimit te kontrates midis paleve.

Ne zerin e Shpenzimeve te shtyra jane perfshire shpenzime te cilat i takojne me shume se nje periudhe ushtrimore, dhe amortizohen ne nje vit kalendarik te tilla si: sigurime vjetore per automjete e shoqerise, abonime etj keto shpenzime nuk i perkasin te gjithë vitit 2014 dhe si te tilla jane klasifikuar si shpenzime te shtyra per tu amortizuar ne vitin 2015.

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

10. AKSIONE DHE PJESEMARRJE TE TJERA NE NJESITE E KONTROLLUARA

Ne kete ze jane perfshire investimet e shoqerise ne blerjen e aksioneve te paleve te lidhura, tabela e meposhteme paraqet pjesemarrjen ne vlere dhe perqindje deri me date 31.12.2014. Gjate vitit 2014 kane ndodhur ndryshimet si me poshte:

Aksione dhe pjesmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	Shenim	31 dhjetor 2014	%	31 dhjetor 2013	%
Tirana Logistic Park		1,194,288,030	64%	1,194,288,030	64%
Mane TCI		689,750,000	100%	689,750,000	100%
Albchrome		139,720,000	100%	139,720,000	100%
ALCRED		114,722,879	100%	114,722,879	100%
Neptun		90,000,000	90%	90,000,000	90%
MZF		86,600,000	100%	86,600,000	100%
RFZ Building		20,716,514	100%	20,716,514	100%
Neptun Maqedoni		19,452,131	60%	19,452,131	60%
BookStore		16,071,470	100%	4,534,686	100%
Neptun KS	a)	4,199,100	60%	-	0%
Saccta		909,992	65%	909,992	65%
ACREM		100,000	100%	100,000	100%
Kid Zone KS	b)	76,951	55%	-	0%
Green Coast	c)	100	100%	-	0%
AES	d)	100	100%	-	0%
Kid Zone		90	90%	90	90%
UED	e)	-	0%	28,148,000	100%
Sadcom	f)	-	0%	144,224	60%
Totali		2,376,607,357		2,389,086,547	

- a) Investim 60% ne shoqerine Neptun Kosove e cila zoterohej indirekt nepermjet shoqerise Neptun Maqedoni.
- b) Investim ne masen 55% ne aksionet e shoqerise Kid Zone Kosove per vleren 76,951 leke.
- c) Investim 100 % ne aksionet e shoqerise Green Coast, shoqeri e cila do te investoje ne projekte turistike gjate vitit 2015.
- d) Investim 100% ne aksionet e Albanian Energy Supplier, nje shoqeri e cila ne te ardhmen do te investoj ne sektorin e energjitikes.
- e) Shoqeria ka shitur aksionet e zoteruara ne UED me vlere nominale 28,148,000 leke
- f) Shoqeria ka shitur 60% te aksioneve te zoteruara ne shoqerine Maqedonase SadCom me vlere 144,244 leke

11. AKSIONE DHE INVESTIME TE TJERA NE PJESEMARRJE

Ne kete ze perfshihen investimin ne shoqeri te pakontrolluara. Ne daten 31.12.2014 situata paraqitet si me poshte e detajuar.

Aksione dhe pjesmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm për pasqyrat financiare të pakonsoliduara):

	Shenim	31 dhjetor 2014	%	31 dhjetor 2013	%
Balfin Finance B.V		658,759,157	38.5%	658,759,157	38.1%
Final		59,109,750	38.5%	22,902,000	22.9%
Milsped Albania	a)	28,040,000	50%	-	0%
TBU	b)	428,571	30%	-	0%
Macrem		174,488	25%	174,488	25%
Faleminderit	c)	1000	20%	-	0%
CMB	d)	140	1%	-	0%
Total		746,513,106		681,835,644	

- a) Investim 50 % ne aksionet e shoqerise Milsped Albania, shoqeri e cila operon ne fushen e transportit nderkombetar, ndermjetesim dhe perfaqesim doganor, maarevshje ne fushen e logjistikes.
- b) Investim 30 % ne aksionet e Tirana Business University, nje universitet jopublik.
- c) Investimin 20% ne kuotat e shoqerise Faleminderit
- d) Shoqeria CMB ka vendosur dhurimin e 1% te kuotave te saj ne vleren 140 leke.

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

12. KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA

Ne kete ze perfshihen kontributet ne vlore monetare te Shoqerise Balfin per palet e lidhura, per nevojat financiare qe kane patur shoqerite gjate vitit financiar 2014 si dhe detyrime te tjera te shoqerive jo te kontrolluara. Duke pasur parasysh gjendjen e likuiditetit si dhe performancen financiare te seciles shoqeri, Balfin do te vendose gjate vitit 2015 nese keto kontribute do te kalojne si kapital aksionar apo do te kthehen.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 riparaqitur
Njësi te lidhura		
Mane TCI	1,957,846,310	1,976,139,504
Neptun	219,742,520	246,021,687
Acrem	120,531,672	90,129,814
Neptun Maqedoni	60,545,358	53,304,630
Kid Zone KS	49,997,800	-
Green Coast	19,863,438	-
MZF	6,567,764	-
Fortune Techonoly LTD	5,914,714	5,917,246
ACR Holding	3,608,044	-
Macrem	50,274	4,957,295
AES	30,000	-
BookStore	1,061	11,157,181
Kid Zone	-	16,453,098
CMB Albania	-	126,600,600
RFZ Building	-	85,716,550
Totali nga njësi te lidhura	2,444,698,955	2,625,397,606
Armand Mane	15,556,050	-
Erion Cino	7,000,000	7,000,000
Totali nga persona te lidhur	22,556,050	7,000,000
Totali	2,467,255,005	2,632,397,606

13. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi. Ne kete grup jane paraqitur gjendjet e aktiveve afatgjata materiale qe perbehen nga Instalime teknike, mjete transporti, pajisje zyre dhe informatike si dhe te tjera ne shfrytezim. Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Aktivitet afatgjata materiale jane prone e shoqerise dhe jane dokumentuar ne menyre te rregullt me faturat tatimore perkatese. Vlerat e mesiperme te AAM-ve, përputhen me inventarin fizik te tyre date 31.12.2014

	Aktive Afatgjata Jomateriale	Aktive Afatgjata Materiale				
	Software	Instalime Tekninke dhe Pajisje	Mjete Transport i	Pajisje zyre dhe informatike	Mobileri e Pajisje	Totali
Balanca ne 01 Janar 2014	-	4,545,792	9,779,870	32,490,055	14,107,598	60,923,315
Shtesa	1,159,658	-	-	-	-	1,159,658
Pakesime	-	(4,408)	-	-	-	(4,408)
Balanca ne 31 dhjetor 2014	1,159,658	4,541,384	9,779,870	32,490,055	14,107,598	62,078,566
Amortizimi						
Balance ne 01 Janar 2014	-	(2,527,894)	(4,562,172)	(12,798,077)	(8,565,910)	(28,454,053)
Ndryshimi i vitit	(144,957)	(396,365)	(910,265)	(3,652,140)	(2,092,587)	(6,036,656)
Balanca ne 31 dhjetor 2014	(144,957)	(2,924,259)	(5,472,437)	(16,450,217)	(10,658,497)	(34,490,709)
Vlera e mbetur ne 31 dhjetor 2014	1,014,701	1,617,125	4,307,433	16,039,838	3,449,101	26,428,198

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

14. HUATE DHE OBLIGACIONET AFATSHKURTRA

Ne kete ze jane perfshire detyrimet e afatshkurtra, te cilat priten te mbyllen brenda vitit 2015, keto hua jane klasifikuar si hua Afatshkurtra.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Ervin Gjikota	15,423,888	15,423,888
Albania Fashion	4,483,367	4,430,071
MZ Fashion	-	32,629,463
RFZ Building	52,505,796	-
Kid Zone	37,595,902	-
Albchrome	1,691,551	-
Totali	111,700,504	52,483,422

15. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE

Ne kete grup jane perfshire detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve. Ne njohjen fillestare zerat e ketij grupi jane vleresuar me kosto. Ne vijim te njohjes fillestare, huate dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo difference midis kosos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Furnitore	25,833,449	28,567,367
Totali	25,833,449	28,567,367

16. DETYRIMET TATIMORE

Ne llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit "Per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore", "Per TVSH-ne", per "Tatimin mbi te ardhurat" etj, te zbatueshme per aktivitetin e shoqerise tone. Detyrimet tatimore te papaguara me date 31.12.2014 sipas natyres se tyre dhe vlerat perkatese jane paraqitur ne tabelen e poshteshenuar. Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe tatimit mbi te ardhurat e muajit dhjetor 2014 jane paguar ne muajin Janar 2015.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Sigurime shoqerore e shendetesore	941,326	613,787
Tatim mbi te ardhurat	650,855	842,551
TVSH	431,079	-
Tatim fitimi viti 2013	-	3,550,248
Totali	2,023,260	5,006,586

17. DIVIDEND PER TU PAGUAR

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo difference midis kosos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne kete ze eshte paraqitur detyrimi per pagesen e dividendit te shperndare nga shoqeria per ortakun te tij te vetem, ky detyrim pritet te paguhet ne vitin 2015.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Divident i pagueshem	120,879,411	120,879,411
Totali	120,879,411	120,879,411

18. TE ARDHURA TE SHTYRA

Ky ze perfaqeson arketimin e nje shume sipas kushteve te kontrates midis Balfin dhe CMB Albania te cilat do te njihen ne vitin 2015 pasi te plotesohen te gjitha kushtet e kontrates.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Te ardhura te shtyra CMB	70,070,000	70,100,000
Totali	70,070,000	70,100,000

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

19. HUA AFATGJATA

Ne kete llogari jane paraqitur detyrimet e shoqerise per Huate te marra nga bankat e nivelit te dyte per te plotesuar nevojat e saj per investime te ndryshme qe ka kryer. Ne vitin 2014 shoqeria ka shlyer totalisht kete detyrim. Situata krahasimore me vitin 2013 paraqitet si me poshte:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Banka Kombetare e Greqise	-	2,920,789
Veneto Bank	-	125,605,797
Totali	-	128,526,586

20. HUAMARRJE TE TJERA AFATGJATA

Ne kete llogari jane paraqitur detyrimet e shoqerise per financimet e marra nga ortakut i tij i vetem si edhe nga shoqerite e Grupit, per investimet e kryera. Kontributi i kryer nga ortakut do te konsiderohet te kaloje ne rriten e kapitalit te shoqerise ne nje moment te mevonshem.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Alcred Food Processing CO	994,153,453	822,977,012
Kontribut nga ortakut Samir Mane	888,025,281	922,588,829
Tirana Logistic Park	133,307,607	133,267,288
Altin Daka	-	28,040,000
Neptun	-	49,539,374
Total	2,015,486,342	1,956,412,503

21. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i shoqerise perbehet nga kuotat e kapitalit, te cilat jane njohur me vleren nominale. Ne menyre te permbledhur, te dhenat per zoteruesit e kapitalit, numerin e kuotave dhe % e zoterimit, paraqiten ne tabelen e meposhteme:

KAPITALI I ORTAKEVE					
Nr.	Zoterues te kapitalit	Nr. i kuotave	Date 31.12.2014		Struktura ne %
			Vlera nominale ne Lek	Vlera totale e kapitalit ne Leke	
1	Samir Mane	100	32,162,050	3,216,205,000	100%
	Totali	100	32,162,050	3,216,205,000	100 %

22. SHITJET NETO

Ne kete rubrike jane paraqitur te ardhurat nga aktiviteti i shoqerise qe eshte Sherbimi i konsulences per shoqerite e tjera te Grupit. Ky sherbim perfshin konsulence financiare, juridike, teknologjise se informacionit dhe menaxheriale.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Sherbim konsulence	57,495,844	52,630,638
Totali	57,495,844	52,630,638

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

23. TE ARDHURAT TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga qerate dhe te ardhura nga dividendet. Gjate vitit 2014 shoqeria ka njohur si te ardhur nga dividendi i shperndare nga shoqerite e kontrolluara.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Acrem	69,799,540	62,539,017
Macrem	14,237,328	8,968,535
Neptun	-	27,192,727
Neptun Maqedoni	15,517,213	-
Kid Zone	-	16,453,099
Total te ardhurat nga Dividenti	99,554,081	115,153,378
Green Coast	153,965	36,311
Total te ardhurat nga Qeraja	153,965	36,311
Total	99,708,046	115,189,689

24. SHPENZIME NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet e tjera te veprimtarise, te klasifikuara sipas natyres, jane paraqitur ne vijim:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Qera	15,210,258	15,246,503
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	11,625,107	11,023,346
Shpenzime te tjera per sherbime	8,529,998	18,494,564
Shpenzime te tjera per zyre	3,417,407	598,645
Per karburant	2,330,734	2,916,231
Shpenzime te tjera	2,201,609	553,057
Transferime, udhetime dieta	1,589,567	4,138,014
Ambjente te perbashketa	1,493,856	1,497,399
Blerje energji/uje/avull	1,173,770	1,226,987
Per riparim makinash	793,780	119,464
Blerje/Shpenzime te tjera per kancelari	489,583	567,209
Shpenzime per pritje dhurata, Sponsorizime	412,575	4,469,795
Shpenzime per sherbime bankare	372,867	692,457
Shpenzime noteriale ligjore	292,708	1,852,324
Shpenzime marketing	206,985	75,000
Per sigurim dhe taksa	37,888	9,833
Taksa dhe tarifa vendore	37,120	37,120
Sigurime te tjera	-	362,037
Shpenzime garancie	-	3,731
Gjoha dhe demshperblime	-	109,735
Totali	50,215,811	63,993,452

25. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

Ne kete ze perfshihen shpenzimet per interesa nga huate qe ka shoqeria si edhe fitime/humbje nga shkembimet valutore.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Fitimi nga kembimet valutore	18,776,358	3,155,042
Te ardhura nga interesat	59,134,088	991,172
Te ardhura te tjera	1,364,853	-
Shpenzime per interesa	(4,397,174)	(18,649,559)
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	(20,488,806)	(801,577)
Totali	54,389,318	-15,304,922

BALFIN SH.P.K
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2014

(Vlerat ne ALL)

26. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2014 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 është 15%. Niveli taksimit për fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2013 ka qënë 10%.

Bazuar ne legjislacionin Fiskal ne Shqiperi te ardhurat nga dividendi jane te perjashtuara nga tatimi dhe si te tilla jane zbritur nga rezultati financiar i periudhes perkatese.

Më poshtë jepet detajimi i llogaritjes së tatim fitimit:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	91,505,545	300,507,718
Te ardhura nga dividendet	(99,708,046)	(115,189,689)
Shpenzime te pazbriteshme	6,682,587	17,566,949
Humbje/Fitim Tatimor	(1,519,914)	202,884,978
Humbje te mbartura	-	(94,159,703)
Fitimi i tatueshem	(1,519,914)	108,725,275
Tatimi	-	12,084,621

27. PALET E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me kompanitë e zoteruara nga Balfin. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut. Gjate vitit 2015 shoqeria do te vazhdoj dhenien e sherbimit te konsulences financiare per shoqerite e grupit apo per pale te treta, gjithashtu edhe vazhdimin e kryerjes se investimeve ne shoqeri te reja, apo zgjerimin e atyre egzistuese.

28. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që kane ndikuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor. Nga data 16.02.2015 administrator i shoqerise eshte Znj. Edlira Muka.